



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2020:001601

Datë: 15.03.2024

Numri i dokumentit: 05459906

C.nr.10/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtaren Pajtesë Boshnjaku, në çështjen juridiko kontestimore paditësit, K.T dega në P. rruga “Emrush Miftari” numër 1, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit, Labinot Lulaj, nga Peja - Zyrtar Ligjor Regjional, kundër të paditurve S.V dhe Sh.V që të dy nga fshati C., rruga ‘T.H’, nr. 54,56 Komuna e I. , nga baza juridike, kthim borxhi, në prezencën e përfaqësuesit të paditësit e në mungesë të të paditurve, në seancën e shqyrtimit kryesor publik, me datë 29.02.2024 bie këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET NË TËRËSI E BAZUAR, kërkesëpadia e paditëses K.T dega në Pejë, rruga “Emrush Miftari” numër 1, dhe **DETYROHEN** të paditurit S.V dhe Sh.V që të dy nga fshati C., rruga ‘Tahir Hasku’, nr. 54,56 Komuna e Istogut, që në mënyrë solidare, paditësit t’ia paguajnë borxhin nga Marrëveshja për Kredinë, në shumën e përgjithshme prej 5,043.93 euro, me kamatë ligjore prej, 8%, duke filluar nga data 08.01.2020, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënimit të përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHEN të paditurit në mënyrë solidare, t’ia kompensojnë shpenzimet e procedurës paditëses në shumën prej 407.02 euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse:

Paditësi përmes përfaqësuesit të tij, me datën 08.01.2020, ka paraqitur padi nga baza juridike kthim i borxhit nga marrëveshja për kredinë. Gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se në tërsi betem pranë padisë dhe kërkesëpadisë së precizuar në shumën prej 5,043.93 euro, ku në bazë të provave të administruara konsideroj se u vërtetua themelsësia e kësaj kërkesëpadie, prandaj kërkojë nga gjykata që të njëjtën ta aprovoj si të bazuar në prova dhe në ligj dhe kërkojë që t'i obligojë të paditurit që paditësit t'ia kthejnë borxhin në shumën e lartëcekur së bashku me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e ushtrimit të padisë respektivisht 08.01.2020 e deri në përmbushjen definitive të detyrimit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar të specifikuar në seancën e datës 29.02.2024.

Të paditurit edhe përkundër faktit se kanë pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, përgjigje në padi nuk kanë dhënë, gjithashtu për seancën e shqyrtimit gjyqësor kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt, dhe të njëjtit nuk kanë prezantuar, ndërsa mungesën nuk e kanë arsyetuar, andaj gjykata duke vepruar konform propozimit të palës paditëse e duke u bazuar në nenin 112 e në lidhje me nenin 423 par.4 të LPK-së ka mbajtur seancën në mungesë të palëve të paditura.

Gjendja faktike e vërtetuar:

Gjykata në këtë çështje juridiko - kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, sipas propozimit të të autorizuarit të paditësit, ka zhvilluar procedurën e provave dhe ka administruar: Njoftimin e datës 06.02.2019 për të paditurin S.V nga paditësi, Njoftimin e datës 06.02.2019 për të paditurën Sh.V nga paditësi, Marrëveshjen për kredinë e datës 05.12.2017 e lidhur në mes të paditësit si kredi dhënës dhe të paditurive si kredi marrës, së bashku me shtojcën numër 1 të marrëveshjes mbi pengun, plani i pagesave të kredisë, fletë radhitja e pagesave e të paditurit S.V e datës 04.10.2023, ekspertizën finaciare të datës 25.10.2023, të punuar nga eksperti Ukë Sadiku.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku e në lidhmëri njëra me tjetrën e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore arriti në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar, pasi që vërtetoi këtë gjendje faktike:

Gjykata në këtë çështje juridike, nga gjendja e fakteve dhe provave të çështjes, ka gjetur si të vërtetuar faktin se në mes palëve ndërgjyqësve ka ekzistuar marrëdhënia kontraktuale për marrjen e kredisë, me çka, në mes palëve ndërgjyqësve janë krijuar të drejta dhe detyrime dhe rrjedhimisht detyrimin për përmbushjen e tyre.

-Nga njoftimi i datës 06.02.2019 i paditëses ndaj të paditurit gjykata vërtetoi faktin se i padituri Sefedin Vuthi, është njoftuar nga paditësi për mospërmbushjen e obligimeve (pagesave) sipas Kontratës së Kredisë, përkatësisht për mospagesën për muajin e dytë, në shumën prej 383.14 €.

-Nga njoftimi i datës 06.02.2019 i paditëses ndaj të paditurit gjykata vërtetoi faktin se e paditura Shpresa Vuthi, si bashkëkredimarrëse është njoftuar nga paditësi për mos përmbushjen e obligimeve (pagesave) sipas Kontratës së Kredisë, për mospagesën për muajin e dytë, në shumën prej 383.14 €.

-Nga Marrëveshja për kredinë e datës 05.12.2017, së bashku me shtojcën nr. 1 të marrëveshjes mbi pengun, gjykata vërtetoi faktin se marrëveshja është themeluar në mes palëve ndërgjyqëse, në cilësi të kredi dhënësit këtu paditësi dhe si kredi marrës këtu të paditurit, për shumën prej 5,000.00 €, destimini i së cilës ishte kredi për blerjen e tokës bujqësore, me normë nominale të interest 20.50 % (vjetore) dhe normë efektive të interest 22.47 %.

-Nga plani i pagesave, shtojca nr. 2, gjykata vërtetoi faktin për mënyrën e pagesave që të paditurit do të duhej ti kryenin ndaj paditësit, në afat kthimi prej 36 muajsh, me këstin mujor prej 187.21 €.

-Në bazë të ekspertizës financiare të ekspertit Ukë Sadiku të datës 25.10.2023 gjykata konstatoi faktin se kredimarrësit kishin dështuar në përmbushjen e detyrimeve në tërësi ndaj kredidhenësit, kishin paguar vetëm 14 këste të kredisë në shumën e tërsishme prej 2,554.94 euro, që përbëhe, t 1,645.08 euro e borxhit kryesor dhe 909.86 euro interesin e rregullt, pa u paguar kanë mbetur 22 këste të kredisë nga marrëveshja e lidhur në mes palëve, borxhi i mbetur është në emër të, kryegjesë së papaguar shuma prej 3,354.92 euro, interesi të kontraktuar të pa paguar shuma prej 829.53 euro, ndëshkimet (penalitetet e llogaritura) në shumën prej 859.48 euro, e që totali i borxhit (obligimit) përbën shumën prej 5,043.93 euro.

Baza Ligjore:

Në bazë të dispozitës së nenit 8 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve është përcaktuar se “ *Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që t’i përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre*”, ndërsa në dispozitat e nenit 245 paragrafi 1 të LDM-së, ka paraparë se “*Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë*”, me nenin 305 të të njëjti ligj është përcaktuar se “ *1. Debitori është në vonesë kur nuk e përmbush detyrimin brenda afatit të caktuar për përmbushje. 2. Në qoftë se afati për përmbushje nuk është caktuar, debitori është në vonesë kur kreditori ta ftojë që ta plotësojë detyrimin e vet, verbalisht ose me shkrim, paralajmërim jashtë gjyqësor, ose duke filluar ndonjë procedurë, qëllimi i së cilës është realizimi i përmbushjes të detyrimit*”. Ndërsa me nenin 375 të ligjit të lartëcekur është përcaktuar se “*Kur detyrimi ka si subjekt një shumë të hollash, debitori ka për detyrë të paguajë shumën e njëjtë të të hollave, përveç nëse kreditori dhe debitori merren vesh ndryshe në pajtim me ligjin*”.

Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës:

Gjykata duke vendosur lidhur me kërkesëpadinë e paditësit e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 245, 305, 375 dhe 398 të LMD-së, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar për faktin se të paditurit duke mos e kryer detyrimin e tyre, rezulton se i kanë mbetur borxh paditësit shumën prej 5,043.93 euro si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, andaj ndërmjet palëve ndërgjyqësve është krijuar raporti detyrimor, në të cilin paditësi e ka cilësinë e kreditorit ndërsa të paditurit e kanë cilësinë e debitorit, detyrim ky i themeluar sipas Marrëveshjes për kredinë e datës 05.12.2017 e cila do të duhej të përmbushej në afat prej 36 muaj në këste mujore prej 187.21 €, duke përfshirë edhe normën nominale të interest prej 20.50% dhe normën efektive të interest prej 22.47%, por e njëjta përkundër njoftimeve paraprake nga paditësja për dy të paditurit dhe atë nga njoftimet e dates 06.02.2019, ka mbetur e papëmbushur ashtu që janë përmbushur vetëm 14 këste të kredisë në shumën e tërsishme prej 2,554.94 euro, që përbëhet, shuma prej 1,645.08 euro e borxhit kryesor dhe shuma prej 909.86 euro, interesin e rregullt, ndërsa pa u paguar kanë mbetur 22 këste të kredisë nga marrëveshja e lidhur në mes palëve, ashtu që borxhi i mbetur është, në emër të kryegjesë së papaguar shuma prej 3,354.92 euro, interesi të kontraktuar të papaguar shuma prej 829.53 euro, ndëshkimet (penalitetet e llogaritura) në shumën prej 859.48 euro, e që totali i borxhit (obligimit) përbën shumën prej

5,043.93 euro, fakt ky i vërtetuar përmes ekspertizës financiare të cilës gjykata ia fali besimin në tërësi duke e vlerësuar të punuar në mënyrë objektive dhe profesionale.

E duke ju referuar dispozitës së nenit: 7 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, *palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të ligjit të procedurës kontestimore, *secila palë ndërgjyqëse, ka për detyrë t'i provoji faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*.

Gjykata vendimin lidhur me kamatën e gjykuar e mbështet në dispozitat e nenit 382 të LMDsë, ku gjykata ka pranuar si moment të fillimit të llogaritjes së kamatës ditën e ushtrimit të padisë me datën 08.01.2020, duke ia njohur paditëses kamatën vjetore prej 8%, në tërësi ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 382 par.2 të LMD-së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, Gjykata ka vendosur komform nenin 452.1 të LPK-së, me çka i ka detyruar të paditurit që paditësit t'ia paguajnë shpenzimet e procedurës në shumë prej 407.02 eur0 dhe atë, në emër të taksës për padi, shumën prej 61.00 €, në emër të vërtetimit të kopjeve të provave, shumën prej 46.02 euro dhe për nxjerrjen e proves me ekspertizë nga ë[mija financiare, shumën prej 300.00 euro.

Nga të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143 të LPK-së, lidhur me nenin 245, 305, 375 dhe 398 të LMD-së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA NË ISTOG

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.10/20, datë, 29.02.2024

G j y q t a r j a

Pajtesë Boshnjaku

Këshillë juridike :

Kundër këtij aktgjykimi lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.